

Erzana Beqiri

DOMOSDOSHMERIA E KRIJIMIT TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, DHE SFIDAT ME TË CILAT BALLAFAQOHET KY PROCES.

Abstrakti

Ndërtimi i shtetit demokratik të bazuar në rend e ligj është misioni i çdo shoqërie që synon prosperitetin dhe zhvillimin e saj. Në realizimin e këtij misioni rolin kryesor e ka administrata shtetërore, e cila konsiderohet edhe si “zemra” e funksionimit të shtetit. Funksionimi i saj kërkon ushtrim të kontrollit të vazhdueshëm, në mënyrë që të parandalohen situatat kur administrata keqpërdor autorizimet që ia kanë njohur aktet juridike në fuqi. Kësaj detyre më së miri i përgjigjet gjyqësia administrative e cila shërben si një kontroll i jashtëm, i pavarur dhe fuqiplotë për të ndaluar çdo tentativë të administratës për të keqpërdorur autorizimet dhe shkelur ligjet. Republika e Kosovës ka krijuar një sistem gjyqësor që përfshin edhe gjyqësinë administrative, respektivisht kontrollin gjyqësor të administratës, dhe atë përmes krijimit të një departamenti të veçantë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, përkatësisht të Departamentit për Çështje Administrative. Praktika e këtij departamenti ka treguar se gjyqësia administrative kosovare nuk po jep rezultatet e nevojshme dhe as të pritshme, andaj reformimi i saj është i domosdoshëm, dhe atë sa më parë. Për këtë arsye krijimi i Gjykatës Administrative shikohet si një mënyrë adekuate për të ju përgjigjur problematikave të sistemit aktual të gjyqësisë administrative. Gjykata Administrative do të jetë një zgjidhje konkrete që do ti mundësojë qytetarëve një gjykim të shpejtë të konflikteve administrative që ata kanë me organet e administratës. Kësisoj, përmes krijimit të saj, përcaktimit të kompetencave dhe mënyrës së organizimit si dhe formës së funksionimit, Republika e Kosovës do të realizojë një gjyqësi administrative që do të garantojë kontroll gjyqësor të punës së administratës më cilësor, zgjidhjen e konflikteve administrative më shpejtë dhe në mënyrë më profesionale, dhe padyshim edhe rritjen e drejtësisë dhe besimit në drejtësi në Republikën e Kosovës.

Fjalë kyçe: gjyqësia administrative, drejtësia, kontrolli gjyqësor, konflikti administrativ